



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Personat t Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr.17  
Prishtinë, më 9.9. 2008, ora 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Personat të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rrustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Mbledhjen e monitoruan :

- Nexhat Shatri nga Presidenca e Republikës së Kosovës
- Nga stafi mbështetës i Komisionit Rrahim Demaj e Sulltane

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

**R e n d d i t e**

- 1 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 17.7.2008,
- 2 Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës lidhur me barazinë gjinore ,
- 3 Shqyrtimi i peticioneve të parashtruar nga disa qytetarë të Kosoves ,
- 4 Te ndryshme

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

Kryesuesi - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 8. 7. 2008**

**Kryetari** - Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes kaluar.

**2 Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës lidhur me barazinë gjinore ,**

**Kryetari** - Theksoi se Qeveria e Republikës ia ka procedua Kuvendit të Kosovës programin për barazi gjinore me qëllim të shqyrtimit . Dokumenti i ofruar e ka mbështetjen në Ligjin për barazi gjinore, konventat CEDAW dhe në legjislacionin Evropian dhe ka për synim krijimin ,zhvillimin ,integrimin e barazisë gjinore duke i siguruar ndërhyrjet që të jenë në përputhje me nevojat dhe mundësit e institucioneve të vendit . Ai ishte i mendimit komisioni të formoi një grup punues i cili do të analizonte dokumentin dhe pastaj t’ia prezantojë Komisionit për miratim .

**Drita Maliqi** – shtroi nevojën e inkorporimit të e zyrtareve për barazi gjinore, pasi ka vërejtur se në disa komuna në vend tyre, funksionojnë njësit për të drejtat e njeriut. Ajo kërkoi zbatimin e Ligji për barazi gjinore që i obligon organet e qeverisjes lokale t’i themelojnë zyrat për barazi gjinore në komuna. Me propozimin e saj u pajtuan të pranishmit.

Kryetari duke u bazuar në rregullat e Rregullores së punës së Kuvendit i propozoi Komisionit për formimin e grupit punues për shqyrtimin e raportit të Qeverisë së Kosovës dhe lidhur me nxori këtë:

**V e n d i m**  
Për formimin e grupit punues

- I. Formohet grupi punues me këtë përbërje :
  - Hajredin Hyseni ,kryetar ,
  - Sanije Aliajaj ,anëtare dhe
  - Vezira Emrush anëtare.
- II. Grupi punues ,ka për detyrë hartimin e raportit që ka të bëjë me programin e Qeverisë së Kosovës lidhur me barazinë gjinore i cili do t’i dërgohet në shqyrtim Komisionit .

## **2 Shqyrtimi i Programit të Qeverisë së Kosovës lidhur me barazinë gjinore**

**Prof Dr. Nerxhivane Dauti** i raportoi Komisioni lidhur me përmbajtjen e peticioneve dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Ajo shtoi se me seriozitet dhe kompetencë i ka shqyrtuar ankesat e paraqitura nga Këshilli i Pavarur Mbikqyresë i Kosovës dhe ka kërkuar për çdo ankesë të ketë përfundimin me specifikat e saja.

**Shkresa** nr. 892 të datës 6.5.2008 e ushtruar nga Razije Lipoveci që ka të bëjë me mos pagesën mujore nga Ministria e Shëndetësisë. Komisioni i rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t’i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 928 të datës 12.5.2008, Shqipe Krasniqi nga Prizreni ka ushtruar ankesë , për mospërfilljes së vendimit të KPM .Komisioni i rekomandon, të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t’i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1132 , të datës 11.6.2008 e ushtruar nga Beqir Krasniqi lidhur me ndërprerjen e marrëdhënie të punës. Komisioni i rekomandon, të kërkohet nga autoritetet e punëdhënëse që t’i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1215 të datës 24.6.2008 e ushtruar nga Rrahim Ramadani nga Prishtina që ka të bëjë për mos zbatimin e vendimit të KPM .Komisioni, rekomandon, të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t’i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1207 të ushtruar nga Selatin Tenezhdolli nga Prishtina , që ka të bëjë me ankesën

lidhur me ndërprerjen e marrëdhënie të punës. Komisioni, rekomandon të kërkohet nga autoritetet e punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1306 , të datës 7.7.2008 e ushtruar nga Kenan Hadri nga Prizreni , që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënie të punës. Komisioni rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1308 , të datës 7.7.2008 e ushtruar nga Ismet Sylja nga Mitrovica , që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënie të punës. Komisioni, rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1131 të datës 11.6.2008 e ushtruar nga Avdullah Serroli nga Malisheva , që ka të bëjë me mos zbatimin e vendimit të KPMK. Komisioni rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1344, të datës 14.7.2008 e ushtruar nga Naser Hysenit nga Ferizaj , që ka të bëjë ndërprerjen e marrëdhënie të punës dhe mos zbatimin të vendimit të KPM. Komisioni rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Shkresa** nr. 1345, të datës 14.7.2008 e ushtruar nga Visar Latifi , që ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënie të punës .Komisioni, rekomandon të kërkohet nga autoriteti punëdhënëse vendimin e largimit nga puna, me synim të ndriçimit më mirë të pozitës së tij juridike në kontekst me paraqitjen e ankesës.

**Shkresa** e datës 19.8.2008 e ushtruar nga Mustaf Shala nga Prishtina , që ka të bëjë ndërprerjen e marrëdhënie të punës dhe mos zbatimin të vendimit të KPM Komisioni rekomandon të kërkohet nga autoritetet punëdhënëse që t'i zbatojnë vendimet e organit vendimarrës dhe të informojnë Komisionin me ecurinë e zhvillimit të procedurës.

**Naim Rrustemi** duke u ndërlidhur me procedurën e shqyrtimit të peticioneve ceku se nuk mund të anashkalohet KPM i Kosovës, pasi bie në kompetencë të tij në bazë të Rregullores së UNMIK-ut mbi shërbyesit civil nr. 2008/12 dhe jo Gjykatat e përgjithshme .Pastaj ngriti çështjen e fushëveprimit të Komisionit lidhur me nxjerrjen e rekomandimeve duke kërkuar për një bashkëpunim me të gjithë aktoret të ekzekutivit dhe gjyqësorit, me qëllim të zbatimit të vendimeve të plotfuqishme .

**Hajredin Hyseni** duke u lidhur me diskutimet e parafolësve shtroi nevojën e zhvillimit të takimit komisioni me Ministrinë e Drejtësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatën Supreme të Kosovës në të cilin do të trajtonim shkaqet e mos zbatimit të vendimeve të plotfuqishëm.

**Vezi Emrush** lidhur me vendosjen e peticioneve ceku se nuk ka plan strategjik për zgjidhjen e tyre Ajo njëherit apeloj që të ketë bashkëpunim me komisionet homologe që marrin vendime. Mirëpo deri tani nuk ka përgjegjësi nga institucionet shtetërore të Kosovës lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut . Ajo kritikoi ia adresoi KPM –së cila nuk është në nivelin e detyrës .

Pastaj diskutoi për çështje që janë të lidhura me të drejtat e njeriut. Lidhur me këtë pikë diskutuan deputetet : Ibrahim Makolli ,Sanije Alijaj ,Radmilla Vujoviq.  
Ishte konstatim i të gjithëve për gjetjen mjeteve me qëllim të zbatimit të vendimeve të plotfuqishme nga ana e ekzekutivit dhe gjyqësorit ,pasi ka ngecje në zbatimin e vendimeve

#### **4 Te ndryshme**

**Kryetari** – vuri në pah për një vizitë studimore jashtë Kosovës të komisionit me komisionet homologe të parlamenteve evropiane. Ai ishte i mendimit që së pari të vizitohet Republika e Shqipërisë, pasi ka një demokraci më të zhvilluar. Gjithashtu u kërkua takimi me komisarin e burgjeve të Kosovës .

**Luljeta Shehu** kërkoi nga Komisioni të vizitohet Murgu i Prishtinës ku do njoftohemi për se afërmi me gjetjen mortore .

*Mbledhja përfundoi në orën 14:30.*

Përgatitur nga  
Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

**Kryesuesi i Komisionit**  
Ismet Beqiri